

Regjistrimi në vitin e parë të shkollës së mesme

Vitin që vjen, fëmija juaj do të shkojë në shkollën e mesme.

Në Gent ka një numër të madh shkollash të mundshme.

Prandaj është mirë që të regjistroheni, që të mund të përzgjidhni shkollat tuaja të preferuara.

Kjo ndodh online dhe është e mundur vetëm brenda një periudhe të caktuar.

Regjistrimi është i mundur nga 22 marsi deri në 21 prill, në orën 12 të drekës.

Dita apo ora në të cilën regjistrohet fëmija juaj, nuk luan asnjë rol për sa kohë është brenda kësaj periudhe.

Nuk ka ndonjë kufizim në numrin e shkollave që ju mund të përzgjidhni.

Pra, përzgjidhni disa shkolla të ndryshme.

Rezultatin do ta merrni në 3 maj.

Shumë suksese.